

**KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME**  
**(Lloji kuota)**

Sot, ne daten **18.09.2021 (dymije njezet nje)**, ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate dhurimi kuotash si me poshte vijon :

**SHITES:** Pandush LAKO, i biri i Guri-t, i datëlindjes 24.11.1992, shtetas shqiptar, lindur ne Korçë dhe banues ne Sheshi i Teatrit, L9, Nr.14, Korce, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, qe ne kontrate referohet si “Shitesi”

dhe

**BLERES:** Mertiaz SPAHIU, i biri i Eqrem-it, i datëlindjes 10.09.1972, shtetas shqiptar, lindur ne Korçë dhe banues ne Biloku Demokracia, L7, Nr.2, Korçë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, qe ne kontrate referohet si “Bleresi”


Shitesi dhe Bleresi, referuar te dy se bashku do te quhen “Palet”.

**Te pergjithshme**

1. Shitesi eshte ortak ne Shoqerise ALFA COURIER SERVICES shpk, rregjistruar me NIPT M11517018C dhe me seli ne Autostrada Tirane-Durres, Km. 10, Rruga Dytesore Vore, ketu e me poshte referuar si Shoqeria.
2. Ne kete Shoqeri pala shitesese eshte pjesemarrrese ne masen 40%, me 1 kuota.
3. Bleresi eshte ortak ne Shoqerise ALFA COURIER SERVICES shpk, rregjistruar me NIPT M11517018C dhe me seli ne Autostrada Tirane-Durres, Km. 10, Rruga Dytesore Vore, me pjesemarrje aktuale ne masen 30%, me 1 kuota.
4. Duke qene se Shoqeria, aktualisht ka situaten financiare te atille, sic eshte pershkruar ne Vendimin e Asamblese se Ortakeve te dates 17.09.2021, dhe duke marre parasysh se Bleresi eshte ortak egzistues i kesaj shoqerie, Shitesi deshiron t'i shese Bleresit te drejttat reale te tij mbi te gjithe kutotat qe Shitesi zoteron ne kete Shoqeri dhe Bleresi deshiron ti bleje sipas parashikimeve te kesaj kontrate.
5. Ne perputhje me “Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave”, sipas Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar dhe Statutin e Shoqerise ALFA COURIER SERVICES, hartohet kontrata e shitjes se kuotave si me poshte vijon:

**Neni 1**  
**Objekti**

- 1.1 Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Shitesi i kalon Bleresit, nepermjet shitjes, te gjithe pjesemarrjen e tij ne kapitalin e Shoqerise si me poshte.
- 1.2 Shitesi i shet Bleresit 40 % te kuotave te Shoqerise, me vleren 100.000 ( njeqind mije ) leke.
- 1.3 Bleresi nga ana tjetere blen nga shitesi kuotat si me lart ne kete shoqeri, dhe pranon te paguaje vleren e mesiperme.
- 1.4 Vlera e plote e kontrates eshte paguar plotesisht dhe palet nuk kane pretendime tani apo ne te ardhmen.



- 1.5 Duke qene se Bleresi eshte ortak ne te njejten Shoqeri, kuotat e transferuara prej kesaj kontrate, do ti shtohen kuotave te tij egzistuese.
- 1.6 Shitja nuk eshte e renduar me asnje kusht apo barre te cilen Shitesi eshte i detyruar te permbushe per kete shitje, kundrejt Bleresit.

**Neni 2**  
**Kalimi i kuotave dhe pjesemarrja ne Shoqeri.**

- 2.1 Kalimi i kuotave behet me shitje, me vleren 100.000 ( njeqind mije ) leke.
- 2.2 Pas nenshkrimit te kesaj kontrate dhe me rregjistrimin ne QKB Shoqeria do te kete pjesemarrjen si me poshte:
- Mertiaz SPAHIU, pjesemarrja ne Shoqeri 70 %, 1 kuote.
  - Alket KUTROLLI, pjesemarrja ne Shoqeri 15 %, 1 kuote.
  - Fredi KUTROLLI, pjesemarrja ne Shoqeri 15 %, 1 kuote.

**Neni 3**  
**Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat**

- 3.1 Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat nga Shitesi te Bleresi si dhe te drejtat e detyrimitet e ketyre te fundit, i fillojne efektet juridike menjehere me nenshkrimin e kontrates.
- 3.2 Pas nenshkrimit kontrata do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Neni 4**  
**Regjistrimi**

Regjistrimi i kalimit te kuotave nga Shitesi te Bleresi ne Qendren Kombetare te Regjistrimit do te kryhet menjehere pas nenshkrimit te kontrates prej Bleresit.

**Neni 5**  
**Ligji i zbatueshem**


Kjo kontrate rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, si dhe dispozitat e aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.

**Neni 6**  
**Zgjidhja e mosmarreshjeve**

Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, ne te kundert juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

PALET

SHITESI  
Pandush LAKO



BLERESI  
Mertiaz SPAHIU

Faqe 2 nga 2

